



Lajmet e Fundit:

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Klienti”

⏏ ⏪ ⏩



Lajmet

Operacionet

03/09/2022

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Klienti”

Finalizohet, nga Komisariati i Policisë Nr. 4, operacioni policor i koduar “Klienti”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Sekuestrohen 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe 1 mjet prerës (thikë).

Vihet në pranga poseduesi.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative se në rrugën “Njazi Mela”, në një lokal, ndodhej një shtetas i armatosur, kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “Klienti”.

Si rezultat i këtij operacioni, u arrestua në flagrancë shtetasi A. B., 47 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve luftarake dhe i municionit”, dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”.

Gjatë kontrollit fizik të shtetasit A. B., shërbimet e Policisë i gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe një mjet prerës (thikë).

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

#angazhimpërkushtimsakrificë 🚔🚔
#tëvendosurkundërkrimit ✅
#24/7nëçdoskajtëvendit
#nëshërbimtëqytetarëve 🚔🚔🇹🇲

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Tiranë – Finalizohet me sukses nga Komisariati i Policisë Nr. 2, operacioni policor i koduar “Twenty two”


Elbasan/Finalizohet operacioni policor i koduar “Last time” ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)